



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:060862
Datë: 01.10.2024
Numri i dokumentit: 06237945

K.DH.Shk II.nr.998/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami në çështjen përmbare të kreditorit Banka për Biznes (BpB) Sh.A., me seli në Prishtinë, rr. "Ukshin Hoti", nr. 128, kundër debitorëve 1. "Univer Import" SH.P.K., me numër të biznesit 810775778 dhe seli në Podujevë, rr. "E Xhamisë"; 2. M.K. me adresë në Prishtinë, rr. "E Vushtrisë", nr. 8; 3. S.K. me adresë në Prishtinë, rr. "E Vushtrisë", nr. 8 dhe 4. B.A. me adresë në Podujevë, fshati Gllamnik, të cilët sipas autorizimit përfaqësohen nga avokat Sylejman Klinaku, me bazë juridike përmbare, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorëve të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.906/23 të datës 19.03.2024, me datë **01.10.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorëve "Univer Import" SH.P.K., me numër të biznesit 810775778 dhe seli në Podujevë, rr. "E Xhamisë"; 2. M.K. me adresë në Prishtinë, rr. "E Vushtrisë", nr. 8; 3. S.K. me adresë në Prishtinë, rr. "E Vushtrisë", nr. 8 dhe 4. B.A. me adresë në Podujevë, fshati Gllamnik, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.906/23 të datës 19.03.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin KPPP.nr. KPPP.nr.906/23 të datës 19.03.2024, ne dispozitiv të aktvendimit ka refuzuar si te pabazuar prapësimin e debitorëve Univer Import" SH.P.K., me numër të biznesit 810775778 dhe seli në Podujevë, rr. "E Xhamisë"; 2. M.K. me adresë në

Prishtinë, rr. "E Vushtrisë", nr. 8; 3. S.K. me adresë në Prishtinë, rr. "E Vushtrisë", nr. 8 dhe 4. B.A. me adresë në Podujevë, fshati Gllamnik,

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor kanë ushtruar ankesë debitorët, (*me pretendime sikur në ankesë*) duke kërkuar nga gjykata e shkallës së dytë të anuloj vendimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr. KPPP.nr.906/23 të datës 19.03.2024, dhe të bie vendim që edhe njëherë të shqyrtohet lënda në gjykatë. Mbi arsyet e lartcekura ka kërkuar nga gjykata të vendos si në propozimin e lartpërmendur.

Kreditori ka ushtruar përgjigje ne ankesë nëpërmjet së cilës ka theksuar se dokumentet të cilat i ka bashkangjitur kreditori paraqesin titull ekzekutiv në kuptim të nenit 22 par.1.7 të LPP-së, që në rastin konkret kemi të bëjmë me kontratën mbi hipotekën që sipas ligjit në fuqi dokumenti i tillë e përmbush kushtin e titullit ekzekutiv andaj ka kërkuar nga gjykata që ankesën e debitorëve ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

- Ankesa e debitorëve është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Banka për Biznes Sh.A., me seli në Prishtinë, ka lëshuar Urdhrin përbarimor P.nr. 223/23, të datës 15.05.2023, mbi bazën e dokumentit përbarimor: Kontratë mbi Hipotekën LRP.nr. 1065/2020 e datës 06.03.2020, e regjistruar sipas Aktvendimit mbi regjistrimin e hipotekës nr. 08-580-02-18068/20 të datës 10.03.2020, për sigurimin e kërkesave nga marrëveshja për përkrahje financiare nr. 32/2020 e datës 28.02.2020 dhe kontratës së kredisë nr. K0020/1027, si dhe Marrëveshjen mbi pengun e luajtshëm K0020/1027 e datës 28.02.2020, e regjistruar në regjistrin e pengut sipas Konfirmimit mbi regjistrimit e pengut me R-20230202-514, për sigurimin e kërkesave nga Kontrata për mbitërheqje nr. K0023/381, për realizmin e borxhit ndaj debitorëve në vlerë prej 35,480.07 EUR me kamatë kontraktuese vjetore nga data e parashtrimit të propozimit e deri në përmbylljen e borxhit, si dhe shpenzimeve të procedurës përbarimore. Debitorët, përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor kanë ushtruar prapësim me të cilin e kanë kundërshtuar urdhrin përbarimor, me arsyetimin se urdhri përbarimor është lejuar në bazë të dokumenteve që nuk janë të përshtatshme për përbarim. Ka shtuar se urdhrin për përbarim e bën të parregullt edhe fakti që nuk përmban të dhënat bazë sipas nenit 27, pika 1.2 të LPP-së si dhe i njëjti është lejuar duke shkelur dispozitat ligjore. I ka propozuar gjykatës që pas mbajtjes së seancës të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përbarimor të shfuqizohet, si dhe të obligohet kreditori që të paguajë shpenzimet për përpilimin e prapësimit. Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se propozimin për përbarim e ka parashtruar si rezultat i mos përmbushjes së detyrimeve nga ana e debitorëve të cilat detyrime rrjedhin sipas dokumenteve si në propozimin për përbarim, e të cilat i përmbajnë elementet e një dokumenti përbarues. Duke qenë se pretendimet e debitorëve të paraqitura në prapësim nuk qëndrojnë dhe se qëllimi i tyre është vetëm shmangia nga obligimet ndaj kreditorit, i ka propozuar gjykatës që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar, ndërsa urdhri përbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, pas vlerësimit të prapësimit, përgjigjes në prapësim dhe shkresave në lëndë, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr. 906/23 të datës 19.03.2024, me të cilin në dispozitiv të aktvendimit ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorëve Univer Import” SH.P.K., me numër të biznesit 810775778 dhe seli në Podujevë, rr. “E Xhamisë”; 2. M.K. me adresë në Prishtinë, rr. ”E Vushtrisë”, nr. 8; 3. S.K. me adresë në Prishtinë, rr. ”E Vushtrisë”, nr. 8 dhe 4. B.A. me adresë në Podujevë, fshati Gllamnik,

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka vlerësuar se dokumenti në bazë të së cilit është lejuar urdhri për përmbarrim, i plotëson kushtet për të qenë dokument përmbarrues dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 22 dhe 27 të LPP-së, si dhe nenin 5 par.2 të Ligjit 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka marr aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj vendimin e gjykatës, lidhur me këtë çështje e pranon edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë faktin se baza juridike për caktimin e përmbarrimit, kushtet ligjore që duhet të plotësohen për të caktuar përmbarrimin sipas dokumentit të përmbarrimit, parashihen sipas dispozitës së nenit 22 par.1 nën par 1.7 dhe me nenin 5 par.2 i Ligjit për Procedurën Përmbarrimore, Ligjit për Procedurën Përmbarrimore, nr.05/L-118 të, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore ku në mesin e dokumenteve përmbarrimore në bazë të cilave organi përmbarrues mund të caktoj përmbarrimin është kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit si dhe edhe kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut.

Dhoma e Shkalles se Dytë, vlerëson se nuk qëndron pretendimi ankimor i debitorit se aktvendimi i atakuar është marrë me konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se dokumenti në bazë të cilit është lejuar urdhri përmbarrimor nuk paraqet dokument përmbarrimor, për faktin se në rastin konkret përmbarruesi privat e ka lejuar përmbarrimin duke u bazuar në Kontratën mbi hipotekën LRP.nr. 1065/2020, e datës 06.03.2020 dhe Marrëveshjen mbi pengun e luajtshëm nr. K0020/1027 e datës 28.02.2020, gjeti se të njëjtat janë janë hartuar në formën e paraparë me ligj janë regjistruar në regjistrat publik, fakt ky që vërtetohet nga Aktvendimi mbi regjistrimin e hipotekës 08-580-02-18068/20 e datës 10.03.2020, respektivisht Konfirmimi mbi regjistrimit e pengut me R-20230202-514,, dhe te njëjtat paraqesin dokumente përmbarruese në

kuptim të dispozitës së nenit 22 par.1 nën par 1.7 i Ligjit për Procedurën Përmbartimore, me të cilën parashihet se “1. *Dokumente përmbartuese janë 1.7. kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit*” ndërsa me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore me nenin 5 përcaktohet si në vijim” 2. *Neni 22 i ligjit bazik, paragrafi 1., pas nën-paragrafit 1.7., shtohet nën-paragraf i ri 1.7a. me tekstin si në vijim. 1.7a. kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut.*

Gjykata e shkallës së dytë ka analizuar edhe pretendimet tjera të debitorit por të njëjta mbesin vetëm në natyrën deklarative dhe të pambështetura në prova konkrete siç parashihet dispozita 69 par.4 të LPP dhe si të tilla nuk janë relevante për vendosje ndryshe prandaj kanë rezultuar si të pathemelta të cilat gjykata ankimore vendosi të refuzojë ndërsa aktvendimin e atakuar vendosi ta vërtetojë.

Përndryshe, në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbartimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II nr.998/24. me datë 01.10.2024

**Gjyqtari,
Faton Bajrami**